

## **BALKANS ACT NOW!**

### **THIRRJE PËR PROPOZIME**

Në kuadër të projektit "*Balkans Act Now- BAN III*", financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në Shqipëri; në partneritet me ASTRA-Anti Trafficking Action, Serbia; Forumi Ndërkombëtar i Solidaritetit -EMMAUS, Bosnje dhe Hercegovinë; Qendra për të Drejtat e Grave, Republika e Malit të Zi; Shoqata për Veprim Kundër Dhunës dhe Trafikimit të Qenieve Njerëzore – Open Gate La Strada, Maqedonia Veriore dhe Komiteti i Helsinkit, Holandë, shpallet Thirrja për Propozime nën Skemën e Sub-Grantimit.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti të BE-së, i financuar në kuadrin e Rrjeteve Themelore Rajonale të Organizatave të Shoqërisë Civile, Reference EuropeAid / 154870 / DH / ACT / Multy, është: Të kontribuojë në rritjen e demokracive pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit në BE në Serbi, Maqedoni, Mali i Zi, Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovinë, duke forcuar ndikimin e shoqërisë civile në rezultatet e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe kapacitetin dhe aftësinë e OShC-ve për të dialoguar në mënyrë efektive me qeveritë, që të prodhojnë ndryshime të qëndrueshme.

Objektivi kryesor i skemës së subgrantimit është që të kontribuojë në monitorimin e kapaciteteve duke siguruar mjaftueshmërinë e të dhënave për raportim, si dhe duke mundësuar një rrugë për OShC-të që të angazhohen drejtpërdrejt në aktivitetet kombëtare dhe rajonale.

Shuma e përgjithshme e vënë në dispozicion në këtë Thirrje për Propozime është 10 000 (dhjetë mijë) Euro.

QNL synon që të shpallë fitues 2 (dy) projekte, të cilët duhet të bien ndërmjet shumave minimale dhe maksimale të grantit: shuma minimale: 5000 (pesë mijë) Euro dhe shuma maksimale: 5000 Euro (pesë mijë)

Afati i fundit për të kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktues është 21 ditë para afatit të dorëzimit.

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit: 15 Korrik 2019, 17: 00h**

Njoftimi për projektet fituese do të jetë më 26 Korrik 2019.

Paketa e aplikimit dhe informacione të mëtejshme mund të gjenden [KËTU](#).